

04 mars 2020

**Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me Zyrën e Këshillimit të Karrierës informoi studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës për Programin Kombëtar të Praktikave të Punës**

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë hapi për herë të pestë aplikimet për Programin Kombëtar të Praktikave të Punës, në Administratën Shtetërore dhe Institucionet e tjera, Publike e Jopublike. Rreth këtij Programi studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës u informuan nga zv. ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë Lorena Haxhiu në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës së UPT-së. Qëllimi i Praktikave të Punës ishte përfitimi i një përvoje kualifikuese për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive profesionale, akademike dhe personale të studentëve, për t'ju mundësuar kalimin e suksesshëm, nga universiteti drejt tregut të punës.

